



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT NR. 108 DATË 18.12.2024 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT TË VITIT 2025 DHE PBA 2025-2027", I NDYRSHUAR (shtesë e buxhetit 2025 me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për mbulimin e detyrimeve dhe detajimi i saj)

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 40, pika 1, neni 41, pika 2"b", neni 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, gërma "d", neni 28, pika 4, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025";

paraqesim propozimin për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Berat të vitit 2025, buxhet i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027", si më poshtë :

Ministria e Financave ka transmetuar nëpërmjet emailit në datën 29.12.2025 shkresën nr. 18059/15 datë 24.12.2025 "Mbi zbatimin e aktit Normativ nr. 11 datë 19.12.2025".

Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 11 datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, Bashkisë Berat i është akorduar shtesë fondi në transfertën e pakushtëzuar shuma 29,264,858 Lekë për shlyerjen e detyrimeve .

Nga ana jonë u krye verifikimi i detyrimeve të prapambetura sipas rendit kohor, si edhe kontrolli i dosjeve me dokumentet shoqëruese justifikuese të nevojshme për likuidim.

Në përfundim, për detyrimet që plotësojnë kushtet për pagesë, propozojmë detajimin e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme prej 29,264,858 Lekë si më poshtë:

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				29,264,858
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			17,366,172
2102001	01	AA102	V111AAG	602	Shpenzime per Vendime Gjyqesore	17,366,172
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			11,760,686
2102001	01	AC102	P912AAR	231	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" dhe parkim nëntokësor	11,760,686
		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			138,000
2102001	01	AF102	V823AAC	602	Blerje materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	138,000
					Total	29,264,858



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,

KRYETAR

Ervin CECA

Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Drejtorja Juridike

2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat, 30.12.2025

MBI MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT " MBROJTJA NGA GËRRYERJA E LUMIT OSUM , RRUGA BYPASS , PRANË URËS SË BILCËS" DHE MIRATIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT PREJ 44,977,207.04 LEKË, TË KËRKUAR PËR FONDET E EMERGJENCAVE CIVILE PRANË AGJENSISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE.

Kryetari Bashkisë mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr 45/2019 " Për mbrojtjen civile", VKM nr 414 datë 08.07.2021" Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", VKM nr. 53, datë 01.02.2023 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile" me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

Propozon " Miratimin në parim të projektit " Mbrojtja nga gërryerja e Lumit Osum , ruga ByPass , Pranë Urës së Bilcës" dhe miratimin e destinacionit të fondit prej **44,977,207.04** lekë, të kërkuar për fondet e emergjencave civile pranë Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile".

Në situatën e emergjencave civile të shkaktuara gjatë muajve Nëntor 2025 për shkak të përmbytjeve të Lumit Osum, është konstatuar që lumi Osum në segmentin pranë Urës së Bilcës rruga Bypass , është devijuar , duke u afruar përgjatë rrugës Bypassit, dhe duke përbërë një rrezik serioz për gjendjen e rrugës dhe dëmtimin e infrastrukturës së saj.

Për këtë arsye, grupi I punës I Bashkisë Berat, ka hartuar projektin e plotë teknik " " Mbrojtja nga gërryerja e Lumit Osum , ruga ByPass , Pranë Urës së Bilcës", I cili parashikon masa mbrojtëse për përballimin e kësaj situate, nëpërmjet ndërtimit të një muri gabion, ndërtimin e sistemit rip-rap, në ballë të murit gabion dhe masat mbrojtëse inxhinierike.

Projekti teknik është I përbërë nga :

- 1-Raporti Teknik
- 2-Specifikimet teknike
- 3-Projekti arkitektonik
- 4-Grafiku I punimeve
- 5-Preventivi

Shuma totale e preventivit të projektit është 44,977,207.04 lekë me TVSH.

Bashkia Berat do të aplikojë pranë Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për fonde për emergjencat civile për projektin më sipër, bazuar në Vendimin nr 53 datë 01.02.2023 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile", ku sipas pikës 7, gërma b, kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak ku të përcaktohet destinacioni i përdorimit të fondit të kërkuar për emergjencën civile.

Kërkojmë nga ana juaj **Miratimin në parim të projektit " Mbrojtja nga gërryerja e Lumit Osum , rruga ByPass , Pranë Urës së Bilcës"** dhe miratimin e destinacionit të fondit prej 44,977,207.04 lekë, të kërkuar për fondet e emergjencave civile pranë Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË

Ervin CECA

